



Pranimar / Doretuar Punime/Prodato Received/Delivered	02-02-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Org /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	435/2021		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.439/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.439/2020 të datës 29.12.2020 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 02.02.2021, mori këtë

### V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.439/2020 e datës 29.12.2020 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi, Zyrtar i Lartë për të Drejtën Ndërkombëtare" në Departamentin për Çështje Ligjore dhe Traktate pran Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 29.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3326/2020 të regjistruar me numër A.nr.439/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Qarkores për Përdorimin e Medimeve Elektronike Sociale, e përcjell tek stafi më datë 28.12.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 05.01.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli më datë 14.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 29.12.2020 me numër protokollit 3326/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e ankuesit për [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net) i datës 29.12.2020; E-mailin e datës 28.12.2020 nga Zyra e Sekretarit në MPJD; Qarkoren për Përdorimin e Mediemeve Elektronike Sociale e datës 22.08.2020; Vendimin me Nr. Ref 176/2020 i datës 01.10.2020 për sistemimin e përkohshëm të ankuesit dhe Përgjigjen në ankesë e datës 14.01.2020 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e palejuar sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.ref 176/2020 të datës 01.10.2020 të z.v. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i sistemuar në pozitën "Zyrtar i Lartë për të Drejtën Ndërkombëtare" në Departamentin për Çështje Ligjore dhe Traktate, pran Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 24.08.2020 ka nxjerr Qarkoren për Përdorimin e Mediemeve Elektronike Sociale për të cilën stafi i ministrisë është njoftuar përmes e-mailit më datë 28.12.2020.

Kundër Qarkores për Përdorimin e Mediemeve Elektronike Sociale, ankuesi me datë 29.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar legjislacionin e shërbimit të jashtëm, respektivisht nenin 32 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimet e Jashtme të Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës mund të përcaktojë të drejta ose detyrime specifike nga marrëdhënia e punës.*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se organi i punësimit nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik ndaj ankuesit për mos respektim të Qarkores për Përdorimin e Mediemeve Elektronike Sociale, kështu që vlerëson se ankesa e ankuesit është e palejuar sepse te njëjtit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit




Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.439/2020

**Avdyl BEKTESHI**  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.